



**KONTRATË KALIMI KUOTASH
ME SHITJE**

Sot, më datë 19.02.2019 (dymije e nentembedhete) para meje Noteres Edlira TELHARAJ, në bazë të nenit 705 e vijues të Kodit Civil, ligjit "Për Noterinë", si dhe ligjit Nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014 Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.9901, Date 14.4.2008, "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare".

personat e mëposhtëm, kërkuan përpilimin e kësaj kontrate shitje kuotash, si më poshtë:

- **Elton XHAVARA**, shtetas Shqiptar, i biri i Nines, lindur me 26.03.1979, ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, i identifikuar me pasaporte me numer personal H90326069Q

*(i cili këtu e në vijim do të quhet **Shitësi**)*

- **Brunilda MUSKOLLARI**, atesia Pellumb, lindur me 29.01.1983, dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, e identifikuar me leternjoftim me nr.personal I35129138H.

*(i cili këtu e në vijim do të quhet **Blerësi**)*

OBJEKTI:

Kalimi i së drejtës së pronësisë, mbi 100% te kapitalit të shoqërisë "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k, zotëruar tërësisht nga Shitësi, te Blerësi, dhe zhveshja e palës Shitëse nga të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga qenia ortak mbi kete shoqëri.

TË DHËNA PARAPRAKE:

- a) Shoqëria "ILYRIAN BOUTIQUE Sh.p.k, është regjistruar si person juridik prane QKR-se, me NIPT L821170080 me kapital themeltar me vlerë 100.000 leke (njëqind mije lekë) dhe ka status aktiv.
- b) 100% te kuotave te Shoqerise "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k zoterohen nga Shiteshi.

Në mbështetje të nenit 73 të ligjit nr. 9901 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ", ndryshuar me Ligjin nr. 129/2014 Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin nr.9901, Date 14.4.2008, "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", nenit 705 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 7829 date 01.06.1994 "Per Noterine" i ndryshuar dhe neneve përkatëse të Statutit të Shoqërisë "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k, Shitësi dhe Blerësi bien dakort midis tyre për shitjen dhe blerjen e kuotave të shitësit, me kushtet si vijon:

Neni 1
Objekti

- 1.1 Objekt i kësaj kontrate është realizimi i shitjes nga Shitësi te Blerësi, i 100 % (njqind përqind) të kapitalit të shoqërisë, kapital i zotëruar teresisht nga Shitësi, dhe zhveshja e ortakut Elton Xhavera nga të drejtat dhe detyrimet qe buronin nga qenia ortak në shoqëri, mbi 100 % te kapitalit, duke kaluar keto te drejta te Blerësi Brunilda Muskollari, e se bashku me to edhe detyrimet qe rrjedhin nga qenia ortak mbi 100% te kapitalit te shoqëise "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k, nga momenti i nënshkrimit te aktit.

Neni 2

Çmimi i shitjes

- 2.1 Palët kanë rënë dakort dhe kanë përcaktuar se çmimi i shitjes se 100% te të kapitalit të shoqërisë "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k është 100.000 leke (njqind mije leke).
- 2.2 Palet pranojnë dhe deklarojne se shuma permendur me siper është likujduar per llogari te Shitesit, jashte kesaj zyre noteriale dhe palet nuk akne pretendime ne lidhje me te.

Neni 3

Kalimi i pronësisë

- 3.1 Me nënshkrimin e kësaj kontrate realizohet kalimi i 100% te kapitalit te shoqërise "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k., nga pala Shitëse te pala Blerëse dhe Shitësi , zhvishet nga të drejtat dhe detyrimet qe buronin nga kjo pronësi nga momenti i nënshkrimit te aktit.
- 3.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala Blerëse, bëhet zotëruese e 100% te kapitalit te shoqërise "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k, duke marre persiper te gjitha të drejtat dhe detyrimet qe burojnë nga qenia pronar edhe mbi 100% të asetëve të shoqërisë "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k.
- 3.3 Blerësi deklaron se eshte dakort me kalimin e 100% te kapitalit te shoqërise ne favor te tij duke mbartur detyrimet qe burojnë nga qenia ortak i vetem ne shoqërine "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k..

Neni 4

Deklarime të palëve

- 4.1 Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se, 100% te kuotave të kapitalit të shoqërisë, "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k, qe i transferohen Blerësit, janë të lira nga çdo barrë dhe menjëherë lirisht të transferueshme te Blerësi, dhe mbi to nuk ka asnjë të drejtë juridike apo monetare të të tretëve.
- 4.2 Blerësi deklaron se e njeh gjendjen e shoqërisë si me siper, e pranon transferimin e 100% te kuotave të kapitalit të shoqërisë "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k, në favor të vet duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet qe do te burojnë nga këto kuota te lindura nga momenti i nënshkrimit te kontrates.

Neni 5

Data efektive e kontratës


- 5.1 Kjo kontratë është efektive, e detyrueshme për palët dhe trashëgimtarët e tyre, qe nga data e nënshkrimit të saj.

Neni 6

Zgjidhja e Kontratës

- 6.1 Asnjë nga palët nuk mund të zgjidhë në mënyrë të njëanshme këtë Kontratë.

Neni 7



Hartimi i Kontratës, aktet bashkëlidhur

- 7.1 Kontrata u hartua në 5 (pesë) kopje të barazvlefshme, në gjuhën shqipe me vlerë të njëjtë ligjore.
- 7.2 Kjo Kontratë zëvendëson çfarëdolloj marrëveshje, kontrate ose çfarëdolloj dokumenti tjetër dhe është e vetmja Kontrate detyruese për Palët në lidhje me objektin e shitjes.
- 7.3 Kontratës i bashkëlidhen aktet e mëposhtme:
 - ekstrakti i shoqërisë "ILYRIAN BOUTIQUE" Sh.p.k,
 - kopje të dokumenteve të identifikimit të palëve.

Neni 8

Legjislacioni i zbatueshëm dhe juridiksioni

- 8.1 Kjo Kontratë është hartuar në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 8.2 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, nëse vetë palët me ndihmë juridike vazhdojnë të mos t'i kuptojnë e zbatojnë, si dhe në rast se vetë palët nuk gjejnë mirëkuptim, mosmarrëveshjet bëhen objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykatës Kompetente.

Neni 9


Interpretimi i Kontratës në tërësi

- 9.1 Çdo kusht apo formulim që mund të sjellë paqartësi do të interpretohet në kontekstin e tërësisë së Kontratës dhe në këndveshtrimin e qëllimit që i shtyu palët të lidhin këtë Kontratë.


Kontrata e shitjes së kuotave, iu lexua palëve me zë të lartë e të qartë nga unë noteri. U lexua prej vetë atyre dhe, palët pasi deklarojnë se e gjejnë atë të rregullt e në përputhje me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, e nënshkruajnë në praninë time. Unë noterja e legalizoj rregullisht, në përputhje me ligjin.

PALËT

SHITËSI



BLERËSI



NOTER

Edlira TELHARAJ





REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2019021816929692
Data e Rezultatit të Kërkimit: 18.02.2019
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 4:09:29PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-577-340
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ELTON NINE XHAVARA
ILYRIAN BOUTIQUE SH.P.K.



Handwritten signature